L I G J
Nr.9541, datë 22.5.2006

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8457, DATË 11.2.1999 "PËR INFORMACIONIN E KLASIFIKUAR "SEKRET SHTETËROR""

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas nenit 1 shtohet neni 1/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 1/1
Fusha e veprimit

Ky ligj zbatohet për të gjitha institucionet shtetërore, qendrore ose të varësisë, për organet e drejtësisë, prokurorisë dhe/ose personat juridikë/fizikë, personat me imunitet, kur për ushtrimin e detyrave të tyre duhet të kenë akses në informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"".

Neni 2

Në nenin 2 "Përkufizime" bëhen shtesat si më poshtë:

"INFOSEC" është zbatimi i masave të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë përpunimit, arkivimit ose transmetimit në sistemet e komunikimit, sistemet e informacionit dhe sistemet e tjera elektronike nga cenimi aksidental ose i qëllimshëm i objektivave të sigurisë: konfidencialitetit, integritetit dhe disponibilitetit.

"Konfidencialiteti" është mbrojtja e informacionit nga aksesi i paautorizuar.

"Integriteti" është mbrojtja e informacionit nga modifikimi i paautorizuar.

"Disponibiliteti" është vënia e informacionit në dispozicion të përdoruesve të autorizuar, kur kërkohet.".

Neni 3

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

1. Në fjalinë e parë, fjalët "tre nivelet" zëvendësohen me fjalët "katër nivelet".

2. Pas shkronjës "c" shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

"ç) "i kufizuar", kur ekspozimi i paautorizuar mund të dëmtojë veprimtarinë ose efektivitetin e institucioneve shtetërore në fushën e sigurisë kombëtare.".

Neni 4

Në nenin 9 shkronja "a", fjalët "tre nivelet" zëvendësohen me fjalët "katër nivelet".

Neni 5

Në nenin 21, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) personi ka zotësi për të vepruar.”.

Neni 6

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 23

Siguria në rrjetet informatike dhe në pajisjet e komunikimit

Masat e sigurisë: sigurimi fizik, sigurimi i personelit, sigurimi i informacionit dhe INFOSEC zbatohen për të krijuar një mjedis të sigurt për funksionimin e sistemeve të komunikimit, të sistemeve të informacionit dhe sistemeve të tjera elektronike.

DSIK është Autoriteti Kombëtar i Akreditimit të Sigurisë.

Drejtoria e Shifrës është Autoriteti Kombëtar për Sigurimin e Komunikimeve dhe Autoriteti Kombëtar i Shpërndarjes.”.

Neni 7

Në nenin 24 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Ministria/institucioni, para nënshkrimit të një marrëveshjeje ose protokolli teknik, që përfshin shkëmbimin e informacionit të klasifikuar, duhet të marrë më parë mendimin e DSIK-së.”.

2. Pas paragrafit të dytë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Para nënshkrimit të një marrëveshjeje ose protokolli teknik, që përfshin shkëmbimin e informacionit të klasifikuar, duhet të jetë lidhur më parë marrëveshja për sigurimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet autoriteteve të sigurimit kombëtar të shteteve palë.”.

Neni 8

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Sistemi i zyrave të regjistrit

Sistemi i zyrave të regjistrit të informacionit të klasifikuar të NATO-s përbëhet nga Zyra e Regjistrit Qendror në DSIK, zyrat e nënregjistrit të informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe pikat e kontrollit, që krijohen në ministri dhe institucione shtetërore.

Ky sistem është përgjegjës për regjistrimin, shpërndarjen dhe administrimin e informacionit të klasifikuar, të shkëmbyer në kuadrin e bashkëpunimit me NATO-n.

Nëpërmjet sistemit të zyrave të regjistrit qarkullon edhe informacioni i klasifikuar i shteteve ose i organizatave të tjera ndërkombëtare.

Ministritë dhe institucionet shtetërore mbrojnë informacionin e klasifikuar të NATO-s, shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare, sipas standardeve që sigurojnë shkallë mbrojtjeje të njëjtë me atë që kërkohet nga NATO-ja, shteti ose organizata ndërkombëtare.”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4904, datë 2.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu